



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

V E N D I M

Nr. 329 Datë 03.07.2024

PËR

PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË Z. {...}, PËR POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATËS SË LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 03.07.2024, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e çështjes znj. Gentiana Muçaj dhe pasi shqyrtoi propozimin e ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ;

V Ë R E N:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...}, në cilësinë e kandidatit për Këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, në zbatim të pikës 144 të Vendimit nr. 424 datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi ka përfunduar vitin akademik 2019 - 2020, është emëruar përkohësisht në pozicionin e Këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.¹

2. Bazuar në nenet 53, 55 dhe 83 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin e Këshillit nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli, me vendimin e tij nr. 497, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për pranim në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor”, ka filluar procedurën e verifikimit për pranimin në shërbimin civil

¹ Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 556 datë 12.11.2020

gjqësor të kandidatëve që kanë përfunduar me sukses formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, ndër të cilët edhe z. {...}. Me këtë vendim, pas zhvillimit të procedurës së shortit, është caktuar relatore anëtarja e Këshillit, znj. {...} ({...}).

3. Gjatë procedurës së vlerësimit, bazuar në pikën 15, seksioni C, kreu VI, të vendimit nr. 424/2020, përmes shkesave përkatëse, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet respektive lidhur me të dhëna të nevojshme, për verifikimin e pasurisë dhe figurës, sipas përcaktimeve të nenit 83 të Ligjit nr. 98/2016, për të gjithë kandidatët në proces verifikimi, midis tyre edhe për z. {...}.

4. Ndërkohë ILDKPKI, pas kontrollit të deklaratës së pasurisë dhe interesave private për z. {...}, ka përcjellë në Këshill, aktin përfundimtar me nr. 343/24 prot, datë 01.03.2021, protokolluar me nr. 5679/18 prot., datë 17.03.2021. Duke iu referuar përmbajtjes së aktit dhe konkluzioneve të tij, rezulton se ILDKPKI ka hartuar raport përfundimtar kontrolli duke iu referuar periudhës kohore 27.01.2017 deri në 17.11.2020, ku ka konkluduar se :

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin,*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë,*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë,*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë,*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4.1 Bashkëlidhur këtij raporti, ILDKPKI ka përcjellë në Këshill, edhe aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin {...}, me nr. 779/31 prot, datë 08.01.2018, që i përkiste kontrollit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit kalimtar, pasi z. {...} ishte subjekt rivlerësimi kalimtar, për shkak të funksionit të ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, të cilin kishte mbajtur në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me Ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” si dhe Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4.2 Pas administrimit të dy akteve si më sipër, në funksion të procedurës së verifikimit iu kërkua ILDKPKI-së, hartimi i një raporti të vetëm dhe të plotë kontrolli, të pandarë në periudha kohore, lidhur me të gjitha pasuritë dhe interesat private të deklaruar nga kandidati në deklaratën e dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 17.11.2020, në kuadër të procesit të verifikimit që është duke u kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për kandidatët për këshilltarë ligjor në Gjykatën e Lartë.

4.3 ILDKPKI me shkresën nr. 2991/9 prot., datë 20.04.2021 ka bërë me dije se është në pamundësi për të hartuar akt të vetëm vlerësimi, që përfshin të dy deklaratat e plotësuara nga subjekti (*deklaratën vetting dhe deklaratën për kandidatët për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë*) për shkak se z. {...} është subjekt i procesit administrativ të rivlerësimit kalimtar dhe pasuria e deklaruar prej tij në deklaratën *vetting* i është nënshtruar kontrollit të plotë në kuadër të këtij procesi, nëpërmjet aktit me nr. 779/31 prot., datë 08.01.2018.

5. Rezulton se emërimi i përkohshëm i z. {...} në pozicionin e Këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, efektet juridike të së cilit kanë filluar në datë 01.12.2020, zgjat deri në përfundim të kësaj procedure verifikimi të pasurisë dhe figurës.

6. Për këto arsye, në rastin e z. {...}, procedura e verifikimit të pasurisë nga organet e rivlerësimit kalimtar, përbën një “çështje paraprake” në kuptim të nenit 66, pika 1 të K.Pr.Administrative, zgjidhja e së cilës duhet të sillte si pasojë pezullimin e procedurës së verifikimit e cila zhvillohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pezullimi i procedurës nga Këshilli në këtë rast ishte i pashmangshëm, jo vetëm për sa u parashtrua më sipër lidhur me ndikimin dhe objektin e verifikimit në të dy procedurat e filluara nga dy organe të ndryshme, por edhe për të shmangur në eventualitetin e mundshëm, konkluzione të ndryshme të dy organeve mbi të njëjtat fakte.

6.1 Nga ana tjetër pezullimi i kësaj procedure verifikimi, lidhej ngushtësisht me pamundësinë e ILDKPKI-së për të bërë një raport të plotë kontrolli të pasurisë së kandidatit, z. {...}, çka e bënte të pamundur vijimin e procedurës së verifikimit të plotë të pasurisë së tij.

7. Pas njohjes me këto rrethana faktike dhe ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 299 datë 13.07.2021 ka vendosur :

1. *Pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për këshilltar ligjor z. {...}, të filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 497 datë 21.10.2020, deri në përfundimin me vendim të formës së prerë të procedurës së verifikimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.*
2. *Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës së Lartë.*
3. *Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
4. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për këshilltar ligjor, z. {...}.*

8. Në vijim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 746 datë 20.03.2024 në përfundim të procedurës së verifikimit të subjektit të rivlerësimit kalimtar z. {...} ka konkluduar, duke vendosur përfundimisht :

“Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...} ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka vendosur :

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, ndihmës ligjor pranë ishGjykatës Administrative të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

8.1 Ky vendim ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar më datë 09.05.2024.

9. Në kushtet kur, tashmë shkaku i pezullimit të procedurës së verifikimit për z. {...}, konsideruar nga Këshilli, në vendimin e tij nr. 299 datë 01.12.2021, kishte rënë dhe nuk ekzistonte më, nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit u vlerësua se duhet të shfuqizohej vendimi i pezullimit dhe çështja të vijojë të trajtohet nga Mbledhja Plenare e cila do të duhet tashmë të zgjidhë në themel çështjen.

9.1 Ndërkohë, rezultoi se Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b të Kushtetutës, nënseksioni I, Procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 736 datë 12.12.2023 ka vendosur :

1. *Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}.*

9.2 Sa sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 32 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, në nenin 68, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, dhe vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve ligjore dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas shortit të hedhur, me vendimin e tij nr. 286 datë 29.05.2024, ka vendosur :

“1. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr. 299, datë 13.07.2021 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor z. {...}” dhe vijimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për këshilltar ligjor z. {...}, pas marrjes formë të prerë të vendimit për verifikimin nga organet e rivlerësimit.

2. Caktimin e znj. Gentiana Muçaj, relatores të kësaj procedure.

3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi bashkë me vendimin përfundimtar që do të merret nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit pasurisë dhe figurës së z. {...}, kandidati për këshilltar ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.”

10. Më datë 03.06.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin 424/2020, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për caktimin/ndryshimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi; - për vendimmarrjen e Këshillit sipas vendimit nr. 286 datë 30.05.2024;

10.1 Brenda afatit tregues, z. {...}, nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

12. Ndërkohë, kur verifikimi i pasurisë dhe figurës, konsiderohet i përmbushur, referuar Vendimit nr. 746 datë 20.03.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi konfirmimin në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Me vendimin nr. 328 datë 03.07.2024 Këshilli I Lartë Gjyqësor ka vendosur :

- 1. Deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë.*

II. LIDHUR ME PROCEDURËN PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL

14. Sikurse u parshtrua më lart, me vendimin nr. 556 datë 12.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}, në cilësinë e kandidatit për Këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, pasi ka përfunduar vitin akademik 2019 - 2020, është emëruar përkohësisht në pozicionin e Këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, në respektim të parashikimit ligjor në pikën 114 të vendimit 424/2020 të Këshillit, ku thuhet se : *“Kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, të cilët kanë kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, emërohen përkohësisht nga Këshilli si këshilltarë ligjorë pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës”*.

15. Sipas pikës 7 të vendimit 424/2020 të Këshillit, rezulton se : *“Kandidatët për kancelarë, për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, që kanë përfunduar programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor”*. Ndërsa, në pikën 9 të vendimit 424/2020 të Këshillit, parashikohet se : *“Këshilltarët ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë i nënshtrohen verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, atij të konfirmimit në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar”*.

16. Bazuar në rezultatet e vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 746 datë 20.03.2024, ku në përfundim të procedurës së verifikimit të subjektit të rivlerësimit kalimtar z. {...} ka konkluduar, duke vendosur përfundimisht mbi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, ndihmës ligjor pranë ish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

16.1 Ky vendim ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar më datë 09.05.2024, pra ka statusin e vendimit përfundimtar.

17. Në interpretim të dispozitave të mësipërme, rezulton se z. {...} i është nënshtuar tashmë verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, proces të cilin e ka kaluar me sukses dhe duhet të pranohet në shërbimin civil gjyqësor.

18. Këshilli vlerëson se një ndër përgjegjësitë e tij të ngarkuara nga Kushtetuta e Republikës është dhe ajo lidhur me drejtimin dhe kujdesjen e mbarëvajtjes së punës në administratën e gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, dhe “ë”, ku theksohet se (citojmë): *“1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”*

19. Në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor, që në nenin 1, pika 1, shkronja “d”² është parashikuar se një ndër qëllimet e tij kryesore është edhe përcaktimi i rregullave lidhur me statusin e nëpunësve civilë gjyqësor. Edhe në nenin 50 e në vijim, deri në nenin 63, të këtij ligji i dedikohet pikërisht statusit të nëpunësve civil gjyqësor në gjykatë. Në këto dispozita³, lidhur me organin kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë *kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit* është ngarkuar të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kjo kompetencë është e sanksionuar në nenin 59 të këtij ligji ku theksohet se “1. *Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.*”.

20. Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për *këshilltar ligjor*, ligji parashikon si të tilla, të njëjtat kriteret të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimin civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kriteret të veçanta për këtë kategori, pra për kategorinë e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, ligji 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në pikën 6 të nenit 34 të tij parashikon : “6. *Këshilltari ligjor jomagjistrat duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlefshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) përvojë profesionale jo më pak se 5 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlerëshëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare; ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Evropian; d) aftësi të shkrimit dhe arsytimit ligjor; dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme;”.*

21. Pas konstatimit të faktit se z. {...} plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji, për të ndjekur Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019–2020, profili Këshilltar ligjor, ai është lejuar dhe në përfundim të Shkollës së Magjistraturës, është emëruar përkohësisht në pozicionin e Këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.

22. z. {...} ka depozituar para Këshillit, kërkesë, protokolluar me aktin nr. 2762 prot., datë 20.05.2024, në të cilën shprehet interesi për emërim si Këshilltar Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

27. Për shkak se z. {...}, ka shprehur interesin për emërimin në pozicionin e Këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë

² Neni 1, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 98/2016 parashikon se: “1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me: ... d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.”

³ Neni 50 i ligjit nr. 98/2016, i ndryshuar parashikon se: 1. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit; e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median. 2. Statusi i nëpunësve civilë gjyqësorë rregullohet nga ky ligj.

pozicion, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin e tij në pozicion, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civil gjyqësor.

22.1 Për këtë qëllim, u verifikua organika e Gjykatës së Lartë, lidhur me organizimin dhe numrin e këshilltarëve ligjorë. Neni 34 i Ligjit për Pushtetin Gjyqësor parashikon, organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, njësi e cila përbëhet nga *këshilltarë ligjorë*, në të cilën *më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar (gjyqtarë)*.

23. Nga informacioni i përcjellë në rrugë elektronike më datë 26.06.2024, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, konstatohet se në organikën e Gjykatës së Lartë lidhur me pozicionin këshilltar ligjor ka në përbërje 32 të tillë, nga të cilët në detyrë, janë 26 këshilltarë ligjorë. Pra konstatohet se ka pozicione të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, në dispozicion të kandidatëve për këshilltarë ligjor.

24. Lidhur me procedurën për emërimin e këshilltarit ligjor, neni 59, pika 3 e Ligjit për Pushtetin Gjyqësor, parashikon se ajo kalon nëpërmjet një procedure *zgjedhje* nga Këshilli të kandidatëve të cilët paraqesin kërkesë. Në një rast të tillë, Këshilli do të duhet të mbajë në konsideratë : **a) renditjen në listën e kandidatëve; b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese**.”. Kjo procedurë e parashikuar nga ligji mban në konsideratë rastin kur kemi më shumë kandidatë sesa vende vakant të lirë, ndërkohë në rastin konkret, të emërimit të z. {...}, për sa kohë që në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë ka pozicione të lira, procedura *e zgjedhjes* e parashikuar nga pika 3 e nenit 59, të ligjit të sipërcituar nuk ka vend për t’u zbatuar.

IV. KONKLUZIONE

25. Sa më sipër, duke konstatuar se z. {...}, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë këshilltar ligjor, në kushtet kur ai ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës dhe është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, si dhe kur pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë ka pozicione të lira, vlerësohet se duhet të pranohet në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për shkak dhe të kushteve dhe nevojave që ka Gjykata e Lartë, ku kontributi i këshilltarëve ligjor konsiderohet i rëndësishëm.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit

nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 36, 42 pika 1 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe vendimit nr. 746 datë 20.03.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor

V E N D O S I :

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të Z. {...}, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
2. Efektet e juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës së Lartë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR